



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GJIROKASTËR  
KËSHILLI I BASHKISË

V E N D I M

Nr. 39 Datë. 01/06 /2026

**“PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR TË EMERGJENCËS CIVILE  
PËR VITIN 2026 PËR MASA PARANDALUESE TË RRËSHQITJES SË SHPATIT TË  
MALIT NË FSHATIN “KOLONJË” GJIROKASTËR**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” ; të Ligjit Nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”; të Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjin Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; VKM Nr.414, datë 08.07.2021 “Për Udhëzimin Nr.09, datë 23.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”; VKB Nr.101, datë 22.12.2025 “Për miratimin e PBA 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026”; Proces-Verbalit të Konstatimit dhe Preventivit të datës 26.05.2026 të Bashkisë Gjirokastër.

Në mbledhjen e datës 01.06.2026, Këshilli i Bashkisë,

**V E N D O S I:**

1. Të miratoj përdorimin e fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile në shumën **1 584 397.56 (nje million e peseqind e tetedhete e kater mije e treqind e nentedhete e shtate presje pesedhete e gjashte) lekë me TVSH**, Për masa parandaluese të rrëshqitjes së shpatit të malit në fshatin “Kolonjë”.
2. Të miratoj përdorimin e fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile në shumën **43 730 (dyzet e tre mije e shtateqind e tridhete) lekë me tvsh** për Mbikëqyrje dhe Kolaudim te objektit të mësipërm
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETAR I KËSHILLIT

Bexhet Baxhella

KRYETARI I KËSHILLIT

Merita Isaraj

